U D H Ë Z I M
Nr.4, datë 17.5.2001

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR.3, DATË 15.2.2001 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MBIKQYRJEN DHE KOLAUDIMIN E PUNIMEVE TË NDËRTIMIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të neneve 7, 12 dhe 18 të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në udhëzimin nr.3, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave, paragrafi i parë i pikës 2 ndryshohet si vijon:

"Mbikëqyrja e punimeve kryhet nga persona, fizikë ose juridikë, të pajisur me licencën përkatëse. Mbikëqyrësi i punimeve caktohet nga kryetari i entit prokurues".

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta